



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 23 janar 2013
Nr. ref.: RK363/13

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. KI90/12

Parashtruesi

Ramadan Kastrati

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Urdhrit SCC-04-0100 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, të 18 gushtit 2004

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është Ramadan Kastrati (përfaqësues ligjor i babait të ndjerë, Q. K.), i përfaqësuar nga Isak Islami, avokat nga Prishtina.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës kërkon vlerësimin e Urdhrit SCC-04-0100 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (në tekstin e mëtejme: DHPGJS), të 18 gushtit 2004.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës është ndalimi i shitjes së lokalit afarist nga Agjencia Kosovare e Privatizimit (në tekstin e mëtejme: AKP) për të cilin parashtruesi pretendon se është në pronësi të tij.
4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës; në nenin 20 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121, të 15 janarit 2010 (në tekstin e mëtejme: Ligji); dhe në rregullin 36 (3) (h) të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja).

Procedura në Gjykatë

5. Më 10 shtator 2012, parashtruesi i kërkesës dorëzoi kërkesë në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës ((në tekstin e mëtejme: Gjykata)
6. Më 13 shtator 2012, Gjykata Kushtetuese kërkoi nga parashtruesi i kërkesës që t'i sqarojë disa aspekte të kërkesës së tij.
7. Më 31 tetor 2012, Gjykata Kushtetuese e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi edhe një herë nga parashtruesi që të sqarojë kërkesën e tij.
8. Më 2 nëntor 2012, Kryetari i Gjykatës caktoi gjyqtarin Robert Carolan Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues në përbërje të gjyqtarëve: Altay Suroy, kryesues, Almiro Rodrigues dhe Arta Rama-Hajrizi.
9. Më 27 nëntor 2012, parashtruesi dorëzoi dokumente shtesë në Gjykatë.
10. Më 17 janar 2012, pasi shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve, siç dëshmohet nga dokumentet e dorëzuara nga parashtruesi

11. Më 27 qershor 1984, Komuna e Gjilanit e lëshoi Vërtetimin nr. 04-431/31, me të cilin vërtetohet se Q. K. (babai i ndjerë i parashtruesit) është pronar i lokalit afarist që gjendet në Gjilan, që nga viti 1966.
12. Më 8 maj 1985, Q. K. ka lidhur një marrëveshje me shkrim për kompensim me Sekretariatit për Punë Komunale-Banesore dhe Pronëso-ro-Ligjore në Gjilan, me të cilën Sekretariati detyrohet t'ia japë Q. K. një lokal afarist prej 30 metrash katrorë si kompensim për tokën dhe për ndërtesat e shpronësuara.
13. Sipas marrëveshjes së lartpërmendur, detyrimi që t'ia japë Q. K. një lokal afarist është dashur të kryhet nga Fabrika e Baterive në Gjilan, e cila, në tokën e shpronësuar kishte ndërtuar ndërtesa për banim, për nevoja të veta, duke i përfshirë lokalet afariste.
14. Më 7 mars 1988, Q. K. paraqiti padi në Gjykatën Komunale në Gjilan, duke kërkuar që kjo gjykatë t'i detyrojë të paditurit (Komunën e Gjilanit dhe Fabrikën e Baterive në

Gjilan) që t'ia japin Q. K. lokalin afarist, sipas marrëveshjes së bërë me shkrim për kompensim, të 8 majit 1985. Rezultati i kësaj padie është i panjohur për shkak të mungesës së dokumentacionit dhe/ose për shkak të faktit se disa dokumente në këtë kërkesë janë të palexueshme.

15. Më 14 mars 1988, Q. K. e dorëzoi një parashtrësë në Këshillin Ekzekutiv të KK në Gjilan, me të cilën shpjegonte se ai ishte dëmtuar në mënyrë drastike nga Fabrika e Baterive në Gjilan, sepse lokali afarist që i ishte dhënë atij “nuk është aspak i përshtatshëm për punë, por për depo”.
16. Më 9 tetor 2003, Gjykata Komunale në Gjilan, me Vendimin C. nr. 529/03, pas propozimit për vendosjen e masave të përkohshme nga paditësi Q. K. (babai i ndjerë i parashtruesit) për shpronësimin e pronës së patundshme (lokali afarist), vendosi: 1) të vendosë masën e përkohshme, dhe 2) t'i ndalojë të paditurit, Komunën e Gjilanit dhe Fabrikën e Baterive në Gjilan, ta shesin lokalin afarist me sipërfaqe prej 40 m2 derisa nuk zgjidhet përfundimisht kontesti i pronësisë.
17. Më 28 qershor 2004, parashtruesi paraqiti një padi në DHPGJS kundër Komunës së Gjilanit dhe Fabrikës së Baterive në Gjilan, duke kërkuar që të mos e vendosin në shitje lokalin e lartpërmendur afarist.
18. Më 18 gusht 2004, DHPGJS lëshoi një urdhër detyrues për rastin SCC 04-0100, duke deklaruar:

“Kjo padi kërkon kompensim që rrjedh nga një urdhër shpronësimi dhe një kërkesë për anulimin e të njëjtit urdhër shpronësimi nëse kërkesa për shpronësim nuk do të miratohet”. Në pajtim me nenet 52 dhe 53 të Ligjit mbi Shpronësimet lexuar me nenin 139 të Ligjit mbi Procedurën Jashtëkontestimore kjo Dhomë ia dërgon vendimin mbi të drejtën e sasisë dhe kompensimit Gjykatës Komunale. Kështu, sipas nenit 17.2 të Urdhërësës Administrative të UNMIK –ut 2003/13, kjo Gjykatë ia përcjell lëndën gjykatës përkatëse vendore. Nëse do të depozitohet ndonjë apelim, ajo duhet të depozitohet në Dhomën e Posaçme.

Ky urdhër është detyrues për palët dhe gjykatën së cilës i është përcjellë lënda”.

19. Më 28 maj 2012, Gjykata Komunale në Gjilan, pas padisë së paditësit Q. K. kundër të paditurave: Komunës së Gjilanit dhe Fabrikës së Baterive në Gjilan, për verifikimin e pasurisë së lartpërmendur, shpalli: (1) veten jokompetente për të vendosur në procedurën e përmendur kontestimore; dhe (2) shkresat e lëndës do t'i dërgohen DHPGJS-së për të vazhduar më tej si gjykatë kompetente.
20. Më 27 gusht 2012, parashtruesi kërkoj nga AKP-ja që të mos e përfshijë lokalin afarist në valën e privatizimit.
21. Më 11 shtator 2012, parashtruesi dorëzoi një parashtrësë në DHPGJS kundër AKP-së përkitazi me kërkesën e tij për mospërfshirjen e lokalit afarist në valën e privatizimit.

Pretendimet e parashtruesit

22. Parashtruesi pretendon se AKP-ja nuk e ka shqyrtuar listën poseduese dhe kopjen e planit të lokalit afarist, të regjistruar nën emrin e Q. K. (babait të ndjerë të parashtruesit).

23. Parashtruesi pretendon se AKP-ja nuk e ka shqyrtuar aktvendimin e DHPGJS (Urdhri SCC 04-0100), e as Aktvendimin e Gjykatës Komunale në Gjilan (Vendimi C. nr. 529/03, të 9 tetorit 2003).
24. Parashtruesi pretendon se ai ka paraqitur kërkesë në Gjykatë për mbrojtjen e ligjshmërisë për rastin nr. SCC-04-0100, të 28 qershorit 2004, DHPGJS-së dhe AKP-së për ndalimin dhe për mospërfshirjen e lokaleve afariste në valën e privatizimit.
25. Parashtruesi pretendon shkeljen e nenit 7 [Vlerat] të Kushtetutës, sepse DHPGJS-ja ka marrë një aktvendim pa e informuar as pronarin dhe as përfaqësuesin e tij të autorizuar me shkrim. Për më tepër, parashtruesi e konsideron veprimin e mësipërm nga DHPGJS-ja si një shkelje të të drejtave dhe të lirive të njeriut sa i përket sundimit të ligjit.

Vlerësimi i pranueshmërisë

26. Për të gjykuar për kërkesën e parashtruesit, Gjykata duhet së pari të shqyrtojë nëse parashtruesi i ka plotësuar kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligjin për Gjykatën Kushtetuese dhe me Rregulloren e punës.
27. Sa i përket kërkesës së parashtruesit, Gjykata i referohet rregullit 36 (3) (h) të Rregullores, i cili thotë:

“Po ashtu një kërkesë mund të konsiderohet si e papranueshme edhe në rastet vijuese kur:

(h) kërkesa nuk është ratione temporis në pajtim me Kushtetutën”.
28. Në mënyrë që të përcaktohet juridiksioni kohori Gjykatës, është esenciale që të identifikohet, në çdo rast specifik, koha e saktë e ndërhyrjes së pretenduar. Duke vepruar kështu, Gjykata duhet të marrë parasysh faktet për të cilat ankohet parashtruesi dhe shtrirjen e të drejtës kushtetuese që pretendohet se është shkelur (*Shih, mutatis mutandis, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Aktgjykimi i Dhomës së Madhe në rastin Blečić kundër Kroacisë, Parashtrësia nr. 59532/0, e 8 marsit 2006, paragrafi 82*).
29. Gjykata vëren se parashtruesi ankohet se është shkelur e drejta pronësore e tij, e garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Në këtë drejtim, parashtruesi kërkon një vlerësim të Urdhrit të DHPGJS-së, Nr. 04-0100, të 18 gushtit 2004.
30. Kjo do të thotë se, ndërhyrja e pretenduar me të drejtën e parashtruesit të garantuar me Kushtetutë, kishte ndodhur para 15 qershorit 2008, që është data e hyrjes në fuqi të Kushtetutës dhe nga e cila datë Gjykata ka juridiksion kohor.
31. Gjykata kishte vendosur ngjashëm në Rastin KI100/10, Aktvendim për papranueshmëri, të parashtruesit Eduard Thaqi (gjithashtu i njohur si Sokol Thaqi) – Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Policisë së Kosovës, Nr. 398-KPS-2002, të 22 tetorit 2002.
32. Rrjedhimisht kërkesa e parashtruesit është *ratione temporis* e papajtueshme me dispozitat e Kushtetutës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, në pajtim me nenin 20 të Ligjit, dhe në pajtim me rregullin 36 (3) h të Rregullores së punës, më 17 janar 2013, njëzëri

VENDOSI

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. Ky vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të botohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese; dhe,
- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese



Robert Carolan



Prof. dr. Enver Hasani